Banka e Shqipërisë

TENDENCAT NË KREDITIM
T4 - 2018

Erjona Suljoti, Olta Manjani, Medvin Shehu dhe Anjeza Gazidede
Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë

JANAR 2019

Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.

P Ë R M B A J T J A

HYRJE 5

PËRMBLEDHJE 6

1. KREDIA PËR BIZNESE 7

2. KREDIA PËR INDIVIDË 11

3. TENDENCAT E KREDITIMIT NË VENDET E RAJONIT 15

HYRJE

Ky material synon të japë një panoramë të tendencave të aktivitetit kreditues në vend. Për të përmbushur këtë qëllim, në të analizohen të dhënat monetare për portofolin e kredisë, si dhe kushtet e kreditimit bazuar në Vrojtimin e Aktivitetit Kreditues. Gjithashtu, pjesë e këtij materiali është edhe një përmbledhje e zhvillimeve të fundit të aktivitetit kreditues në vendet e Evropës Qendrore Juglindore (EQJL).

Statistikat kryesore të analizuara në material janë:

- të dhënat për aktivitetin kreditues të bankave për sektorin rezident të ekonomisë;
- të dhënat cilësore të marra nga vrojtimi i aktivitetit kreditues;
- statistikat për çmimin e kredisë, si në monedhën vendase ashtu edhe në euro;
- të dhënat monetare për vëllimin e kredisë për vendet e rajonit. Vendet e përfshira në analizë janë: Bullgaria (BU), Kroacia (Cr), Rumania (RO), Serbia (Sr), Polonia (Pl), Hungaria (Hu), Republika Çeke (CZ), Maqedonia (IRJM).

Të dhënat e kredisë merren nga bilancet e bankave dhe ato i referohen financimit që bankat vendase i bëjnë sektorit privat rezident - bizneseve dhe individëve. Analiza e portofolit të kredisë bazohet mbi të dhënat e kredisë të rregulluara për efektin e kursit të këmbimit. Gjithashtu, këto të dhëna marrin në konsideratë dhe kreditë e fshira, që bankat kanë ndërmarrë bazuar në vendimin nr. 50, datë 30.03.2015, "Për ndryshimin e rregullores për administrimin e rrezikut të kredisë".

Materiali mbulon të dhënat e publikuara deri më 25 janar 2019, të cilat përshijnë informacion për të dhënat monetare dhe financiare në vend, deri në muajin dhjetor 2018[1], dhe të dhënat e vrojtimit të aktivitetit kreditues për tremujorin e katërt të vitit 2018. Të dhënat e kredisë për vendet e rajonit janë deri në muajin nëntor 2018.

[1] *Të dhënat e muajit dhjetor janë paraprake.*

PËRMBLEDHJE

Kredia për sektorin privat shfaqi përmirësim të ritmeve të rritjes në tremujorin e katërt të vitit, duke reflektuar më së shumti zhvillimet pozitive të muajit dhjetor. Gjatë këtij muaji, u vu re një rritje e ndjeshme e kredisë për biznese dhe asaj në lekë. Përtej luhatjeve afatshkurtra, rritja e kredisë për sektorin privat mbetet e moderuar dhe e kushtëzuar nga kërkesa e dobët e bizneseve për kredi dhe nga politikat konservatore të kreditimit të bankave për këtë grup. Kreditimi në lekë vijon të jetë kontribuuesi kryesor i zgjerimit të kredisë për sektorin privat.

Kredia për biznese ka shfaqur norma rritjeje më të larta se në tremujorin e tretë, duke reflektuar më së shumti rritjen e ndjeshme të muajit dhjetor. Në një këndvështrim më afatgjatë, rritja e kredisë për biznese mbetet në nivele të moderuara. Bankat raportojnë se kërkesa nga bizneset ka qenë disi më e lartë prej bizneseve të mëdha, por standardet e kreditimit kanë mbetur të pandryshuara në tremujorin e katërt të vitit. Rritja e kredisë për biznese është mbështetur si nga rritja e kredisë për likuiditet dhe nga ajo për investime. Në terma të monedhës, vihet re se kontributin kryesor këtë tremujor e ka dhënë kredia në lekë.

Normat e interesit për kreditë e reja në lekë për bizneset janë shfaqur të pandryshuara nga tremujori paraardhës, por lehtësisht më poshtë se në gjysmën e parë të vitit 2018. Ulja e normave të interesit për kredinë në lekë për kapital qarkullues ka dhënë kontributin kryesor në këtë ecuri. Po ashtu normat e interesit për kreditë në euro shfaqen më të ulëta se në tremujorin paraardhës, të ndikuara nga interesat për kredi për likuiditet. Kushtet joçmim të bankave të ofruara për bizneset mbeten në kahun lehtësues edhe në këtë tremujor.

Kredia për individë është rritur me ritme të ngjashme si në tremujorin e tretë, duke ndjekur një trajektore ngadalësuese përgjatë vitit. Në tremujorin e fundit të vitit, zhvillimet në kredinë për individë janë ndikuar nga ngadalësimi i kredisë për blerje banese, ndërsa kredia konsumatore ka shfaqur lehtësisht përmirësim. Në terma të monedhës, edhe në tremujorin e fundit, ka vijuar rritja e kredisë në lekë me norma të larta rritjeje, duke mbështetur dinamikën pozitive të këtij segmenti.

Normat e interesit për kreditë e reja në lekë për individë kanë shfaqur ulje në tremujorin e fundit të vitit, ndërkohë që interesat për kreditë në euro janë disi më të larta se në tremujorin e tretë. Gjatë këtij tremujori, bankat kanë lehtësuar kërkesat për kolateral për individët dhe kanë lënë të pandryshuara kushtet e tjera joçmim.

Aktiviteti kreditues në vendet e rajonit të EQJL-së ka shfaqur dinamikë në përmirësim gjatë muajve tetor-nëntor të vitit 2018. Ky zgjerim i stokut të kredisë për sektorin privat ka rezultuar me bazë të gjerë në terma gjeografikë. Rajoni i Evropës Qendrore vijon të udhëheqë normat vjetore të rritjes së këtij portofoli në të gjithë rajonin e EQJL-së.

1. KREDIA PËR BIZNESE

Ritmet e rritjes së kredisë për biznese janë përmirësuar në tremujorin e katërt të vitit, të ndikuara nga rritja e këtij portofoli në muajin dhjetor. Ky përmirësim duket të reflektojë një kërkesë lehtësisht më të lartë për kredi nga biznesi madh, edhe pse standardet e kreditimit kanë mbetur të pandryshuara. E parë në një këndvështrim më afatgjatë, ritmet e rritjes së këtij portofoli janë të moderuara dhe reflektojnë si një kërkesë të dobët për kredi, ashtu edhe politikat shtrënguese të bankave për bizneset. Për tremujorin e parë të vitit 2019, bankat presin që kërkesa për kredi të jetë më e lartë në përgjigje edhe të lehtësimit të kushteve të kreditimit për këtë segment.

Kredia për biznese, pasi shfaqi një rritje të dobët në muajt tetor-nëntor, shënoi përmirësim të ritmeve të rritjes në 5.4% në muajin dhjetor[2]. Gjatë këtij muaji, kjo kredi u rrit me 7 miliardë lekë, ose dy herë më shumë se zgjerimi i saj në tremujorin e tretë. Megjithatë, raporti i kredisë për biznese ndaj PBB-së, në tremujorin e katërt, vlerësohet të jetë më i ulët se në tremujorin paraardhës, në 23.1%. Ky raport ka vijuar tendencën rënëse gjatë vitit dhe në muajin dhjetor ishte 1.3 pikë përqindje më pak se një vit më parë. Përtej luhatjeve afatshkurtra, portofoli i kredisë për biznese vijon të shfaqë rritje të moderuar, i ndikuar si nga kërkesa e dobët për kredi nga bizneset dhe nga përqasja konservatore e bankave për financimin e tyre. Në muajin dhjetor 2018, raporti i kredive me probleme ndaj totalit të kredisë për biznese shënoi 14.3%, ose 2.3 pp më pak se në tremujorin e tretë të vitit. Pavarësisht rënies së raportit të kredive me probleme në këtë segment, bankat hezitojnë të marrin përsipër rrezik, të ndikuara nga problematikat e kolateralit dhe të aftësisë paguese të bizneseve[3]. Politikat e bankave për financimin e bizneseve mbeten përgjithësisht në kahun shtrëngues në tre vitet e fundit.

Grafik 1. Kredia për biznese
(ndryshime vjetore, tremujore në %* dhe balanca neto)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[2] *Gjatë këtij muaji është vënë re se portofoli i kredisë për biznese është ndikuar ndjeshëm nga fshirjet e kredisë nga bilancet e bankave.*

[3] *Për më shumë shiko rezultatet e vrojtimit të aktivitetit kreditues për tremujorin e katërt 2018.*

Sipas monedhës, vihet re se përmirësimi i kredisë për biznese është mbështetur si në kredinë në valutë edhe në atë në lekë, por kjo e fundit ka shfaqur një rritje dukshëm më të lartë se tremujorët e tjerë të vitit. Norma e rritjes së kredisë në lekë për biznese në muajin dhjetor kulmoi në 6.3%, përkundrejt rritjes mesatares prej 3.5% të shfaqur gjatë vitit. Ndërkohë, kredia në valutë për biznese u rrit me 4.9%, pak më lart se mesatarja e muajve paraardhës.

Grafik 2. Kredia për biznese sipas monedhës dhe qëllimit
(ndryshime vjetore dhe kontributet në pp (%)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Zhvillimet pozitive në kredinë në lekë lidhen kryesisht me kredinë për financimin e nevojave për likuiditet të bizneseve. Kjo kredi shfaqi një ecuri të dobët deri në muajin nëntor, duke u rritur mesatarisht me 0.8% vit mbi vit. Ndërsa në muajin dhjetor, kredia për likuiditete shënoi një normë rritjeje vjetore prej 4%. Për vetë natyrën afatshkurtër të kësaj kredie, ajo shfaq luhatje të ndjeshme, e ndikuar si nga shlyerjet e larta ashtu edhe nga përdorimi i fondeve të veta nga bizneset.

Grafik 3. Kredia për biznese sipas sektorëve të ekonomisë



Burimi: Banka e Shqipërisë. *Tregti përfaqëson sektorin e tregtisë, hotele dhe restorante.

Në tremujorin e katërt, përmirësim të ritmeve të rritjes ka shfaqur edhe kredia e bizneseve për investime. Norma vjetore e këtij portofoli shënoi 6.6% në muajin dhjetor, nivel ky i përafërt me mesataren e rritjes për vitin 2018.

Shpërndarja e kredisë sipas sektorëve të ekonomisë tregon se në tremujorin e katërt të vitit, bankat kanë rritur financimin për bizneset që veprojnë në sektorin e ndërtimit dhe në sektorin e shërbimeve. Kredia për sektorin e tregtisë, hotele dhe restorante ka mbajtur norma rritjeje të ngjashme me tremujorin e tretë, në rreth 8%. Ndërkohë, kredia për sektorin e industrisë dhe të bujqësisë ka shfaqur tkurrje krahasuar me një vit më parë, me përkatësisht 5.4% dhe 4%. Këto zhvillime janë reflektuar në një rritje të peshës së kredisë për shërbimet e tjera ndaj totalit, në 16.2%. Kredia për sektorin e ndërtimit ka ruajtur të njëjtën peshë ndaj totalit si në tremujorin e tretë, prej 15%. Ndërsa, kreditë për sektorët e tregtisë, e industrisë dhe të bujqësisë, kanë zënë një peshë lehtësisht më të ulët ndaj totalit të kredisë për biznese, krahasuar me tremujorin e tretë, në përkatësisht 44.2%, 23.1% dhe 1.5%.

ECURIA E NORMAVE TË INTERESIT

Norma mesatare e interesit për kreditë në lekë dhënë bizneseve private rezultoi 6.5% në tremujorin e fundit të vitit, duke qenë lehtas më poshtë se vlerat e tremujorit paraardhës (6.6%). Kjo ecuri është ndikuar si nga normat e interesit të kredisë për investim, ashtu edhe ato për nevoja likuiditeti. Tek kjo e fundit kanë qenë interesat e kredisë për kapital qarkullues ato që kanë drejtuar uljen, ndërsa interesat për *overdraft* janë shfaqur të luhatshme dhe me prirje rritëse. Norma e interesit për kredinë për investime në lekë shënoi mesatarisht 5.8%, nga 6.0% një tremujor më parë. Krahasuar me gjysmën e parë të vitit, niveli i tyre aktual gjendet lehtas më lart. Interesat në këtë kategori kanë shënuar ulje vetëm për investime në pasuri të paluajtshme, ndërkohë që janë rritur për blerjen e pajisjeve dhe për çelje të biznesit. Pavarësisht luhatjeve afatshkurtra, krahasuar me një vit më parë, normat e interesit për kreditë e reja për biznese kanë mbetur në nivele lehtësisht më të ulëta.

Grafik 4. Ecuria e normave të interesit për kreditë në lekë për bizneset private



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Normat e interesit për kreditë në euro të bizneseve janë ulur në tremujorin e fundit, duke reflektuar kryesisht ecurinë e interesave për likuiditet. Mesatarisht, ato rezultuan 4.1% në këtë tremujor, nga 4.3% në tremujorin e mëparshëm dhe 4.2% në gjysmën e parë të këtij viti. Sipas qëllimit të përdorimit të kredisë, ndryshimet në krahasim me tremujorin e mëparshëm janë shfaqur tek kredia për likuiditet, ndërkohë që në krahasim me një vit më parë edhe interesat e kredisë për investime në euro shfaqen në kahun rënës.

Grafik 5. Ecuria e normave të interesit për kreditë në euro për bizneset private



Burimi: Banka e Shqipërisë

KUSHTET E TJERA TË KREDITIMIT

Për tremujorin e fundit të vitit 2018, bazuar në rezultatet e Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues, kushtet dhe termat e përgjithshëm të kreditimit për bizneset janë raportuar disi të lehtësuar[4]. Kjo tablo ishte rezultante e mbajtjes thuajse të njëjtë të faktorëve të lidhur me çmimin e kredisë dhe lehtësimit të pakët të komponentin joçmim për kreditë e reja dhënë bizneseve. Në tremujorin e fundit të vitit 2018, rritja e madhësisë së kredisë u raportua si i vetmi faktor me ndikim në kahun lehtësues të kushteve e termave të kreditimit, ndërkohë që të gjithë zërat e tjerë përbërës të kategorisë joçmim mbetën të pandryshuar nga një tremujor më parë.

Në një hark kohor afatmesëm, kushtet dhe termat e përgjithshëm për kreditë e reja akorduar bizneseve duket të jenë lehtësuar, nxitur nga përqasja e bankave për të ulur në vijimësi marzhet e aplikuara mbi kreditë për këtë segment. Nga ana tjetër, bankat në periudhën afatmesme duket se janë treguar disi konservatore në përcaktimin e kushteve joçmim, kryesisht në sajë të shtimit të kërkesave për kolateral në raport me kredinë e disbursuar.

[4] *Për detaje referojuni https://www.bankofalbania.org/Politika_Monetare/Vrojtimet/Vrojtimi_i_aktivitetit_kreditues/*

Grafik 6. Kushtet dhe termat e kreditimit për bizneset, të ndara në dy shtyllat kryesore (majtas) dhe të detajuara për kushtet joçmim (djathtas)*



Burimi: Banka e Shqipërisë.

*: *Vlerat përfaqësojnë balanca mes përgjigjeve pozitive e negative, sipas pyetësorit drejtuar bankave mbi aktivitetin kreditues në vend, i cili është rishikuar në T2 2018, duke sjellë edhe faktorë të rinj pjesë përbërëse të kushteve joçmim. Në kushtet çmim përfshihen marzhi i aplikuar mbi kreditë normale dhe ai mbi kreditë me rrezik. Në kushtet joçmim përfshihen komisionet, madhësia e kredisë, maturiteti maksimal i kredisë, kërkesa për kolateral në raport me kredinë e marrë, si edhe kushtëzimet që lindin nga marrëveshja e kredisë.*

2. KREDIA PËR INDIVIDË

Kredia për individë është rritur me ritme të ngjashme si në tremujorin e tretë, duke ndjekur një trajektore ngadalësuese përgjatë vitit. Në tremujorin e fundit të vitit, zhvillimet në kredinë për individë janë ndikuar nga ngadalësimi i kredisë për blerje banese, ndërsa kredia konsumatore ka shfaqur lehtësisht përmirësim të ritmeve të rritjes. Në terma të monedhës, edhe në tremujorin e fundit ka vijuar rritja e kredisë në lekë me norma të larta rritjeje, duke mbështetur dinamikën pozitive të këtij segmenti. Për tremujorin e parë të vitit 2019, bankat presin të vazhdojnë lehtësimin e standardeve për këtë grup, gjë që pritet të gjenerojë edhe kërkesë më të lartë për kredi.

Kredia për individë ka shfaqur një ecuri të qëndrueshme gjatë tremujorit të katërt, duke u rritur mesatarisht me rreth 7.3% vmv, përkundrejt rritjes prej 7.6% në tremujorin e tretë. Në terma absolutë, zgjerimi tremujor i këtij portofoli shënoi 2.3 miliardë lekë, pothuajse njësoj si në tremujorin paraardhës. Ecuria pozitive e kreditimit për këtë grup është ndikuar si nga një kërkesë vazhdimisht e lartë e individëve për financim, ashtu edhe nga standardet më lehtësuese të ofruara nga bankat. Përmirësimi i treguesve të tregut të punës dhe konsumit në vend gjeneron një kërkesë të vazhdueshme të individëve për financim nga bankat. Bankat prej disa vitesh vijojnë të ndjekin një përqasje më favorizuese ndaj individëve, si nëpërmjet kushteve çmim ashtu edhe joçmim të kredisë. Raporti i kredisë për individë ndaj PBB-së vlerësohet të jetë rreth 12% në muajin dhjetor, ose 0.2 pikë përqindje më pak se në vitin 2017, i ndikuar edhe nga efekti i mbiçmimit të lekut ndaj monedhave huaja.

Grafik 7. Kredia për individë
(ndryshime vjetore, tremujore, në % dhe balanca neto)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kontributin kryesor në ecurinë e mirë të kredisë për individë e ka dhënë performanca e qëndrueshme e kredisë në lekë, e cila u rrit me mesatarisht rreth 10.3%. Ndërkohë, kreditimi në valutë për individë duket se po ndjek një trajektore ngadalësuese që prej muajit qershor dhe në muajin dhjetor shënoi një rritje vjetore prej 2.6%. Për pasojë, struktura e kredisë për individë është zhvendosur më tej drejt kreditimit në lekë. Në fund të muajit dhjetor, kjo kredi përbënte 62.7% të totalit, duke qenë 3.5 pikë përqindje më e lartë se një vit më parë. Normat e ulëta të interesit të kredisë për individë, si dhe politikat e ndjekura nga bankat prej disa vitesh për kreditimin e individëve në monedhën në të cilën kanë të ardhurat, mendohet se janë faktorët kryesorë që po e mbështesin këtë dinamikë.

Grafik 8. Ecuria e kredisë për individë sipas monedhës dhe përdorimit
(në % dhe pp)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kontributin kryesor në rritjen e kredisë për individë vijon ta japë kredia për blerje banese. Mesatarisht për tremujorin e katërt, ky portofol u rrit me rreth 5.9%, përkundrejt normës prej 7.6% të shënuar në tremujorin paraardhës. Të dhënat nga Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues tregojnë se ky ngadalësim mund të ketë reflektuar një kërkesë më të ulët për kredi hipotekare. Bankat vlerësojnë se kjo stepje e kërkesës ka reflektuar zhvillimet në tregun e banesave, pavarësisht se ato kanë vijuar të lehtësojnë standardet dhe kushtet e kreditimit për këtë segment. Nga ana tjetër, kredia konsumatore ka shfaqur një ecuri më të mirë se në tremujorin paraardhës, e mbështetur si nga kërkesa më e lartë, ashtu edhe nga standardet dhe kushtet e lehtësuara të kreditimit. Në raport me totalin e kredisë për individë, kjo kredi zë 31.4% ose 1.1 pikë përqindje më shumë se një vit më parë.

ECURIA E NORMAVE TË INTERESIT

Normat e interesit për kreditë në lekë për individë në tremujorin e katërt, ashtu si dhe tek bizneset, janë dalluar për ulje të lehta nga tremujori i kaluar. Interesi mesatar për kreditë për individë në këtë tremujor rezultoi 6.9%, nga 7.1% në tremujorin paraardhës. Interesat e aplikuara ndaj individëve gjithsesi shfaqen më të ulëta se pjesën e parë të vitit dhe viti i kaluar. Sipas qëllimit të përdorimit, në këtë tremujor evidentohet një ulje e lehtë e normave për kreditë konsumatore. Normat e interesit për kreditë hipotekare ndërkohë nuk kanë ndryshuar nga tremujori i kaluar, por gjenden më poshtë se një vit më parë.

Grafik 9. Ecuria e normave të interesit për kreditë në lekë për individët



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Norma mesatare e kredive në euro për individë u rrit në 4.2% këtë tremujor, duke vijuar prirjen rritëse të vërejtur që në tremujorin e dytë. Sipas qëllimit të përdorimit, këtë tremujor, interesat janë rritur veçanërisht tek kreditë hipotekare (në nivelin 3.5%, nga 3.0%), por edhe tek kredia konsumatore (në 5.2%, nga 4.4% në tremujorin tretë). Gjatë këtij viti është regjistruar një rritje e ndjeshme e normave për kreditë *overdraft*, ndërkohë interesat për financimin e blerjes së mallrave kanë treguar ecuri të lehtë rënëse.

Grafik 10. Ecuria e normave të interesit për kreditë në euro për individët



Burimi: Banka e Shqipërisë.

KUSHTET E TJERA TË KREDITIMIT

Për tremujorin e fundit të vitit 2018, bankat tregtare raportuan kushte e terma kreditimi të pandryshuar për individët. Kushtet e lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me çmimin e kredisë ishin thuajse të pandryshuara, sikurse dhe pjesa më e madhe e faktorëve të tjerë që nuk përcaktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë, çmimin e kredisë. Përjashtim bën vetëm kërkesa për kolateral në raport me kredinë e marrë, e cila u raportua si faktor me ndikim në lehtësimin e kushteve dhe termave të përgjithshëm të kreditimit për individët. Kërkesa më e ulët për kolateral gjatë këtij tremujori, solli një balancë pozitive të kushteve joçmim për kreditë e reja të miratuara për individët gjatë periudhës. Përgjatë një periudhe afatmesme, bankat kanë shfaqur një sjellje të orientuar drejt lehtësimit të kushteve e termave të kreditimit të individëve. Në masën më të madhe, lehtësimi i kushteve dhe termave është përcaktuar nga faktorët e lidhur me çmimin e kredisë.

Grafik 11. Kushtet dhe termat e kreditimit për individët, të ndarë në dy kategoritë kryesore (majtas) dhe të detajuara për kategorinë joçmim (djathtas)*



Burimi: Banka e Shqipërisë.

**: Vlerat përfaqësojnë balanca mes përgjigjeve pozitive e negative, sipas pyetësorit drejtuar bankave mbi aktivitetin kreditues në vend, i cili është rishikuar në T2 2018, duke sjellë edhe faktorë të rinj pjesë përbërëse të kushteve joçmim. Në kushtet çmim përfshihen marzhi i aplikuar mbi kreditë normale dhe ai mbi kreditë me rrezik. Në kushtet joçmim përfshihen komisionet, madhësia e kredisë, maturiteti maksimal i kredisë, kërkesa për kolateral në raport me kredinë e marrë, si edhe kushtëzimet që lidhin nga marrëveshja e kredisë.*

3. TENDENCAT E KREDITIMIT NË VENDET E RAJONIT

Aktiviteti kreditues në vendet e rajonit të EQJL-së ka shfaqur dinamikë në përmirësim gjatë muajve tetor-nëntor të vitit 2018. Ky zgjerim ka rezultuar me bazë të gjerë në terma gjeografikë. Rajoni i Evropës Qendrore vijon të udhëheqë normat vjetore të rritjes së këtij portofoli në të gjithë rajonin e EQJL-së.

Teprica e kredisë për sektorin privat ka shënuar normë vjetore rritjeje me rreth 5% mesatarisht në periudhën tetor-nëntor 2018, krahasuar me rritjen e saj prej 4.1% të regjistruar në tremujorin e tretë të vitit. Pavarësisht hendekut midis kërkesës dhe ofertës për kredi të raportuar në Vrojtimin e Aktivitetit Kreditues për vendet e EQJL-së[5], oferta duket se ka akomoduar në masë të gjerë kërkesën më të lartë për financim nga agjentët ekonomikë në këtë rajon. Zgjerimi i kredisë është mbështetur dhe nga normat e favorshme të interesit, të cilat përgjithësisht kanë rezultuar me rënie, ose kanë ruajtur nivelet e tyre të ulëta.

Grafik 12. Ecuria e kredisë për sektorin privat në vendet e rajonit



Burimi: Bankat qendrore përkatëse; llogaritje të autorëve; Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues në rajonin e EQJL-së (CESEE Bank Lending Survey, H2 2018).

Ecuria e kredisë për biznese në vendet e rajonit të EQJL-së tregon një dinamikë pozitive në thuajse të gjitha vendet e rajonit. Normat vjetore të rritjes tregojnë për zgjerim të portofolit të kredisë për biznese mesatarisht me 4.8% në muajt tetor-nëntor 2018, duke shënuar një rritje me rreth 1.3 pikë përqindje nga tremujori i kaluar. Zgjerimi i këtij portofoli udhëhiqet nga normat e larta të rritjes në rajonin e Evropës Qendrore. Ecuria e kredisë për biznese në këtë rajon rezulton më e qëndrueshme dhe gjithmonë në territor pozitiv, mbështetur dhe nga normat e ulëta të interesit për këtë portofol, më të ulëtat në të gjithë rajonin e EQJL-së. Nga ana tjetër, në vendet e Ballkanit, ky portofol shfaqet më i luhatshëm dhe, në pjesën më të madhe, ai ka regjistruar norma tkurrëse. Norma vjetore e kredisë për biznese në Shqipëri shfaqet në përmirësim, krahasuar me një tremujor më parë.

[5] *Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues në rajonin e EQJL-së, për gjysmën e dytë të vitit 2018, përfshin tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit 2018 dhe parashikimet për gjashtë muajt e ardhshëm. Ky vrojtim gjendet në adresën e mëposhtme http://www.eib.org/attachments/efs/economics_cesee_bls_2018_h2_en.pdf*

Grafik 13. Kredia për biznese në vendet e rajonit



Burimi: Bankat qendrore përkatëse; llogaritje të autorëve.

Kredia për individë shfaq ecuri relativisht më të qëndrueshme në dy vitet e fundit. Zhvillimet në portofolin e kredisë për individë konfirmojnë gjithashtu ecuri më të njëtrajtshme edhe në terma gjeografikë. Teprica e kredisë për individë u rrit mesatarisht me rreth 5.1% në terma vjetorë në muajt tetor dhe nëntor, rreth 0.5 pikë përqindje më shumë se në tremujorin e tretë të vitit. Kjo ecuri është mbështetur ndër të tjera dhe nga rënia e normave të interesit në dy-tre muajt e fundit në një pjesë të madhe të vendeve të rajonit. Portofoli i kredisë për individë është zgjeruar me ritme më të shpejta në vendet e Ballkanit. Normat e rritjes së kredisë për individë në vend shfaqen të qëndrueshme në tremujorin e fundit të vitit, në linjë me rajonin.

Grafik 14. Kredia për individë në vendet e rajonit



Burimi: Bankat qendrore përkatëse; llogaritje të autorëve.